



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
AGJENCIA PËR MEDIA DHE INFORMIM
Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

Nr. 126/1 Prot.

Tiranë, më 28 . 2 2025

**RAPORTI I MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË BUXHETIT
PËR AGJENCINË PËR MEDIA DHE INFORMIM**

Periudha e raportimit : Janar – Dhjetor 2024

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, mbështetur në udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr. 2 datë 06.02.2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” si dhe Udhëzimit nr. 14, datë, 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qëndrore”, po ju paraqesim raportin e monitorimit të buxhetit për periudhën 12-mujore për vitin 2024.

Agjencia për Media dhe Informim, për vitin 2024 i është akorduar fondi buxhetor, sipas programit të miratuar, konkretisht:

1150 Shërbime të tjera

Ky program konsiston në mbështetjen buxhetore të shërbimeve të përgjithshme të Agjencisë për Media dhe Informim, dhe përmirësimin e infrastrukturës së saj. Buxheti total i alokuar për Agjencinë për Media dhe Informim, për vitin 2024, si dhe ndryshimet pas rishikimit të tij, paraqiten si më poshtë :

(Në 000/Lekë)

Emërtimi i shpenzimeve	Buxheti Fillestar i vitit 2024	Buxheti Rishikuar i vitit 2024	Plan Janar-Dhjetor 2024	Fakti Janar-Dhjetor 2024
Shpenzime Totale	157,064	0	157,064	110,449

Buxheti fillestar për vitin 2024, i planifikuar për këtë program, është 157,064 (në 000/Lekë). Realizimi faktik për periudhën Janar- Dhjetor 2024 është 110,449 (në 000/Lekë), që përbën 70 % të planit vjetor.

Realizimi i shpenzimeve të 12 - mujorit të vitit 2024 për këtë program, sipas zërave kryesorë paraqitet si më poshtë:

(Në 000/Lekë)

Emërtimi i zërave të buxhetit	Buxheti	Buxheti Rishikuar i vitit 2024	Realizimi në vlerë absolute	Realizimi në përqindje
	Fillestar i vitit 2024			
Paga	106,785	0	88,570	83 %
Sigurime Shoqërore	17,100	0	14,290	84 %
Mallra dhe shërbime të tjera	32,579	0	7,279	22 %
Transferta per buxhet Fam, dhe Indiv.	600	0	311	52 %
TOTALI	157,064	0	110,449	70 %

Përshkrimi i Shpenzimeve dhe Produktit të Programit:

Ky program përfshin financimin për pagat e punonjësve të Agjencisë për Media dhe Informim, si dhe shpenzime për përmirësimin e kushteve të punës dhe rritjen e efektivitetit të burimeve njerëzore, përmes trajnimeve dhe shpenzimeve të tjera të nevojshme (energji, karburant, telefon, etj.). Këto shpenzime janë të lidhura ngushtë me përmbushjen e detyrave të Agjencisë dhe përmirësimin e kapaciteteve menaxhuese dhe implementuese të saj. Numri i punonjësve buxhetore të miratuar sipas planit vjetor është 69 dhe numri faktik është 61 nga ai i planifikuari.

Tregues me bazë gjinore

Numri i vajzave dhe grave në total është 43, të cilat përbëjnë 70% të organikës, 4 janë në nivel drejtuese.

Realizimi i Produktit të Parashikuar për 2024:

Produkti i Agjencisë për Media dhe Informim është **Komunikimi dhe Informimi Mediatik (Kodi 98704AN)**. Ky produkt ka një buxhet të planifikuar prej 157,064 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 110,449 mijë lekë, që përbën 70% të planifikimit.

Konkluzione:

Nga realizimi i shpenzimeve për periudhën Janar – Dhjetor 2024, mund të konkludohet se objektivi i politikës për menaxhimin efektiv të buxhetit dhe zbatimin e suksesshëm të programit është realizuar në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ALTEO HYSI



REPUBLICA E SHQIPËRIE - VIKTORI
AGJENCIA PËR MEDIAN DHE INFORMIMIN
KRYEMINISTRIA